



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 07.09.2023

Nr: 181

Ora: 12:00

VENDIM

**PËR RISHQYRTIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 93, DATË 20.08.2023 TË DEPOZITUAR NGA
PARTIA POLITIKE “PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË”**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 07.09.2023, me pjesëmarrjen e:

Elvin	LAKO	-	Relator
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: Partia politike “Partia Demokratike e Shqipërisë”, përfaqësuar nga z. Indrit Sefa

PERSON I INTERESUAR: “Partia e Lirisë”, përfaqësuar nga Av. Altin Kaziaj

OBJEKTI: 1. Ndryshimin e vendimit nr. 722 të datës 19.08.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarët dhe sekretarin e komisionit të zonës së

administrimit zgjedhor nr. 11, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023”

BAZË LIGJORE: Nenet 21 pika 1 shkronja “b”, 123/1, 124, 126, 129 dhe 130 të K. Zgjedhor

Rrethanat e çështjes:

1. Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 186, datë 11.08.2023, ka caktuar datën 24 shtator 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve të pjesshme për kryetar të bashkisë Kukës. Në zbatim të këtij Dekreti dhe të neneve 19 pika 1 shkronja “n” dhe 29 pikat 1 dhe 4 të K. Zgjedhor, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka marrë vendimin nr. 772, datë 19.08.2023 “Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarët dhe sekretarin e komisionit të zonës së administrimit zgjedhor nr. 11, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023”.
2. Kundër këtij vendimi, partia politike “Partia Demokratike e Shqipërisë” (subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023) ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kritereve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 93 regj., datë 20.08.2023. Në këtë kërkesë ankimore, kërkuesi kundërshton vendimin nr. 722, datë 19.08.2023 të KSHZ, duke kërkuar ndryshimin e vendimit.
3. Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve, vendosi zhvillimin e seancës paraprake, për verifikimin e elementëve të formës dhe përmbajtjes në përputhje me nenin 130, të Kodit Zgjedhor. Në seancë ishin të pranishëm administrata e KQZ-së, përfaqësuar nga zj. Madalena Koja, Drejtoresha e Ligjshmërisë, pala ankimuese, përfaqësuar nga Av. Rezart Kthupi dhe Av. Indrit Sefa dhe personi i interesuar Partia e Lirisë, përfaqësuar nga Av. Altin Kaziaj. Në lidhje me përfaqësimin e Partisë Demokratike të Shqipërisë nga personat e sipërcituar u prapësuan pretendime nga përfaqësuesi i palës së interesuar. Sipas këtij të fundit tagrat e përfaqësimit të Partisë Demokratike të Shqipërisë për të autorizuarin z. Indrit Sefa nuk ishin më në fuqi e për rrjedhojë as autorizimi i

këtij të fundit nuk ishte në fuqi për nënshkruesin e ankimit, z. Rezart Kthupi. Përfaqësuesi i palës së interesuar i bazoi këto pretendime në faktin që autorizimet e z. Lulzim Basha (i lëshuar përpara se ai të dorëhiqej nga pozicioni i kryetarit të PD-së) dhe z. Enkelejd Alibeaj (i lëshuar pas njohjes së tij nga KAS si kryetar i komanduar i PD) nuk kanë më fuqi juridike për aq kohë sa të dy këto persona tashmë janë dorëhequr nga pozicionet që përfaqësojnë Partinë Demokratike të Shqipërisë me të tretët. Pavarësisht këtyre pretendimeve, KAS e legjitimoi z. Indrit Sefa për përfaqësimin e Partisë Demokratike të Shqipërisë duke qenë në cilësinë e përfaqësuesit të kësaj partie politike në KQZ në kuptim të nenit 26 të K.Zgjedhor dhe duke qenë se kjo parti politike është parti parlamentare, ai vijon ta gëzojë këtë status edhe jashtë periudhës zgjedhore për të cilën është caktuar si përfaqësues pranë KQZ-së.

4. Në përfundim të seancës për verifikimin e elementëve të formës dhe përmbajtjes KAS, me vendimin nr. 179, datë 22.08.2023, "Për mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 93, datë 20.08.2023, të depozituar nga "Partia Demokratike e Shqipërisë", vendosi:
 - Mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 93, datë 20.08.2023, të paraqitur nga "Partia Demokratike e Shqipërisë".
5. Përfaqësuesi ligjor i "Partisë Demokratike të Shqipërisë", z. Indrit Sefa, i është drejtuar Kolegjit Zgjedhor, duke depozituar pranë Gjykatës Administrative të Apelit, padinë me objekt "Shfuqizimin e vendimit nr. 179, datë 22.08.2023, të KAS "Për mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 93, datë 20.08.2023, të depozituar nga "Partia Demokratike e Shqipërisë. Detyrimin e Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS), të marrë vendim, lidhur me kërkesën ankimore nr.93 datë 20.08.2023, depozituar nga subjekti "Partia Demokratike e Shqipërisë".
6. Kolegji Zgjedhor, më datë 01.09.2023, zhvilloi seancën gjyqësore në përfundim të së cilës ,me vendimin nr. 34, datë 01.09.2023, ka shfuqizuar vendimin e KAS-it nr. 179, datë 22.08.2023, duke vendosur "Detyrimin e Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve të marrë vendim përfundimtar në lidhje me kërkesën ankimore nr. 93, datë 20.08.2023 të depozituar nga Partia Demokratike e Shqipërisë". Në zbatim të këtij vendimi KAS-i zhvilloi mbledhjen për shqyrtimin në themel të kërkesës ankimore nr. 93, në përbërje të plotë të trupës dhe me pjesëmarrjen e ankuesit z. Sefa

dhe administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm z. Ylli Merkaj. Personi i interesuar, Partia e Lirisë, pavarësisht dijenisë në lidhje me seancën e shqyrtimit administrativ, nuk mori pjesë.

7. Më datë 06.09.2023, KAS në bazë të detyrimeve të përcaktuara në pikën 3, të vendimit nr. 34, datë 01.09.2023 të Kolegjit Zgjedhor, zhvilloi seancën e shqyrtimit në themel të kërkesës ankimore, duke i dhënë të drejtën e parashtrimit të pretendimeve përfaqësuesit të palës ankuese z. Sefa, i cili gjatë deklarimeve të tij kërkoi ndryshimin e vendimit objekt ankimi për arsye se, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të njohë Partinë Demokratike të Shqipërisë si partinë kryesore të opozitës parlamentare, bazuar në numrin e votave të fituara në shkallë vendi për këshillat vendorë në zgjedhjet pararendëse (14 maj 2023) nga partitë parlamentare, pavarësisht faktit se Partia Demokratike e Shqipërisë ka marrë 103,723 vota në shkallë vendi për këshillat vendorë dhe koalicioni “Bashkë Fitojmë” i udhëhequr nga Partia e Lirisë ka marrë 247,883 vota.
8. Në seancën e datës 06.09.2023, gjatë shqyrtimit në themel të çështjes anëtari z. Ilirjan Rusmali, i kërkoi administratës të KQZ-së të kontaktojë me sekretarët e këshillave bashkiakë në 61 bashkitë e vendit dhe të marrë informacion prej tyre për numrin e këshilltarëve bashkiakë që i përkasin subjektit “Partia e Lirisë”. Duke qenë se marrja e këtij informacioni dhe komunikimi me sekretarët e këshillave bashkiakë kërkonte kohë, KAS vendosi pezullimin e çështjes objekt shqyrtimi, për t’u riçelur sërish më datë 07.09.2023, në ora 15:00.
9. Më datë 07.09.2023, riçelet seanca e KAS, duke ju kërkuar administratës vënia në dispozicion e informacionit të kërkuar. Përfaqësuesi i administratës së KQZ-së, z. Merkaj bën me dije se nëpërmjet shkresës nr. 67763 prot., datë 07.09.2023, trupës së KAS sikurse dhe palëve në proces pak para seancës së shqyrtimit në themel të çështjes ju janë vënë në dispozicion të dhënat për 61 bashki në rang vendi, që u siguruan nga ky “hetim”. Nga komunikimi me kryetarët apo sekretarët e këshillave bashkiakë u deklarua në mënyrë jozyrtare se për subjektin “Partia e Lirisë”, janë deklaruar me përkatësi politike të këtij subjekti gjatë konstituimit të këshillave bashkiakë 113 anëtarë këshillash për 53 bashki, ndërsa për 8 bashki anëtarët e këshillave bashkiakë nuk kanë deklaruar përkatësi politike, por janë deklaruar si grup i koalicionit “Bashkë Fitojmë”.

10. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi si provë për shqyrtimin në themel të çështjes:

- Kërkesën ankimore nr. 93, datë 20.08.2023, depozituar nga Partia Demokratike e Shqipërisë;
- Vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 727, datë 19.08.2023 “Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarët dhe sekretarin e komisionit të zonës së administrimit zgjedhor nr. 11, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023”;
- Vendimin e Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor nr. 34, datë 01.09.2023;

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve përfundimtare,

KAS-i konstaton:

1. Neni 28, pika 2, e Kodit Zgjedhor përcakton se “Në rast të zgjedhjeve të pjesshme ose të parakohshme, KZAZ-ja ngrihet jo më vonë se 10 ditë nga data e nxjerrjes së dekretit të Presidentit të Republikës për caktimin e datës së zgjedhjeve”. KZAZ-ja referuar nenit 33 të Kodit Zgjedhor përgjigjet për administrimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve në ZAZ, sipas dispozitave të këtij Kodi dhe akteve nënligjore të nxjerra nga KQZ-ja dhe bën emërimin e administratës zgjedhore të nivelit të tretë të tilla si KQV-të, GNV-të etj.
2. Në lidhje me përbërjen e KZAZ-së, neni 29 i K.Zgjedhor ndër të tjera parashikon se:

“1. KZAZ-ja përbëhet nga 7 anëtarë dhe sekretari, të cilët emërohen nga KQZ-ja, sipas procedurës së mëposhtme:

*a) dy anëtarë propozohen nga partia kryesore e shumicës parlamentare, **dy anëtarë propozohen nga partia kryesore e opozitës parlamentare**, një anëtar propozohet nga partia e dytë e shumicës parlamentare dhe **një anëtar propozohet nga partia e dytë e opozitës parlamentare.***

Në rast se nuk arrihet baraspeshimi politik, sipas kësaj shkronje, grupi përkatës kompensohet me kandidaturat e partisë kryesore deri në baraspeshimin politik shumicë-opozitë;

...

4. Renditja e partive për efekt të ndarjes së vendeve në KZAZ, sipas përcaktimeve të këtij neni, bëhet mbi bazën e numrit të mandateve që ka fituar partia politike nga zgjedhjet pararendëse për Kuvendin. **Në rastin e zgjedhjeve vendore, renditja përcaktohet mbi bazën e numrit të votave të fituara në shkallë vendi për këshillat vendorë në zgjedhjet pararendëse nga partitë parlamentare**”.

3. Bazuar në vendimin nr. 27, datë 7.8.2023, të Komisionit Rregullator, “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”, bazuar në rezultatin e numrit të votave të fituara në shkallë vendi për këshillat vendorë, subjektet zgjedhore janë renditur si vijon:

- Partia Socialiste e Shqipërisë (PS) 579.625 43,11%
- Koalicioni “Bashkë Fitojmë” (BF) 247.883 18,44%
- Partia Demokratike (PDSH) 103.723 7,71%
- Partia Socialdemokrate (PSD) 86.283 6,42%

4. Referuar shkresës së Kuvendit të Shqipërisë nr. 259/1 prot., datë 24.1.2022, partitë parlamentare janë si vijon:

Shumica parlamentare

Partia Socialiste e Shqipërisë - 74 mandate në Kuvendin e Shqipërisë

Pakica parlamentare

Partia Demokratike e Shqipërisë “Aleanca për Ndryshim” – 59 mandate në Kuvendin e Shqipërisë

Lëvizja Socialiste për Integrim – 4 mandate në Kuvendin e Shqipërisë

Partia Socialdemokrate - 3 mandate në Kuvendin e Shqipërisë

Në analizë të dispozitave të Kodit Zgjedhor, rezultati përfundimtar të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023, dhe të shkresës së Kuvendit të Shqipërisë nr. 259/1 prot., datë 24.1.2022, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në vendimin objekt i këtij ankimimi administrativ arsyeton se:

“Neni 29, pika 4, fjalia e dytë, e Kodit Zgjedhor, përcakton qartë procedurën që ndiqet për caktimin e partive që kanë të drejtë të propozojnë anëtarët e KZAZ-ve. Në zgjedhjet vendore, renditja përcaktohet mbi bazën e numrit të votave të fituara në shkallë vendi për këshillat vendorë në zgjedhjet pararendëse nga partitë parlamentare

*Që një parti të gëzojë të drejtën për të propozuar kandidat për KZAZ, **duhet të plotësojë 2 kushte, së pari të ketë marrë pjesë në zgjedhjet pararendëse për organet e pushtetit vendor dhe së dyti, të jetë parti parlamentare.***

Dy anëtarë të KZAZ-së i propozon partia kryesore e shumicës parlamentare e cila ka marrë numrin më të madh të votave në shkallë vendi për këshillat vendor në zgjedhjet e datës 14 Maj 2023, brenda konfigurimit të shumicës parlamentare sipas rezultatit të zgjedhjeve të datës 25 Prill 2021. Një anëtar të KZAZ-së e propozon partia e dytë e shumicës parlamentare, e cila ka marrë numrin më të madh të votave në shkallë vendi për këshillat vendorë në zgjedhjet e datës 14 Maj 2023 pas partisë kryesore të shumicës.

Dy anëtarë të KZAZ-së i propozon partia kryesore e opozitës parlamentare e cila ka marrë numrin më të madh të votave në shkallë vendi për këshillat vendorë në zgjedhjet e datës 14 Maj 2023, brenda konfigurimit të pakicës parlamentare sipas rezultatit të zgjedhjeve të datës 25 Prill 2021. Një anëtar të KZAZ-së e propozon partia e dytë e pakicës parlamentare e cila ka marrë numrin më të madh të votave në shkallë vendi për këshillat vendorë në zgjedhjet e datës 14 Maj 2023, pas partisë kryesore të pakicës.

Kodi përcakton se anëtari i shtatë propozohet në gjysmën e KZAZ-ve nga partia e parë e shumicës parlamentare, kurse gjysma tjetër nga partia e parë e opozitës parlamentare. Në zgjedhjet për kryetarin e bashkisë Kukës, anëtari i shtatë do të përcaktohet me short ndërmjet partisë së parë të shumicës parlamentare dhe partisë së parë të opozitës parlamentare”.

5. Në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023, subjekti zgjedhor, Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, bazuar në dokumentacionin e kandidimit ka deklaruar Partinë e Lirisë si parti udhëheqëse të koalicionit. Në bazë dhe për zbatim të nenit 65, të Kodit Zgjedhor, të gjitha të

drejtat dhe detyrimet që ky ligj përcakton për subjektet zgjedhore përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit.

6. Referuar sa më sipër, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin objekt ankimi, ndër të tjera ka vendosur:

“1. Të caktojë partitë politike që do të propozojnë anëtarët e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor (KZAZ) nr. 11, që do të ngrihet dhe funksionojë për zgjedhjet e pjesshme për Kryetarin e Bashkisë Kukës, të datës 24 Shtator 2023, si më poshtë:

a) Tre anëtarë propozohen nga “Partia Socialiste e Shqipërisë” (PSSH);

b) Dy anëtarë propozohen nga “Partia e Lirisë” (PL);

c) Një anëtar propozohet nga “Partia Demokratike” (PDSH).”

7. Përfaqësuesi i subjektit ankues, Partia Demokratike e Shqipërisë, parashtroi se subjekti zgjedhor koalicioni “Bashkë Fitojmë”, gjatë procesit të regjistrimit të listave të kandidatëve për këshillat vendorë në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, i ka depozituar ato në kundërshtim me fjalinë e fundit të nenit 67 pika 4 të K.Zgjedhor që parashikon se “Për koalicionet përbri emrit të kandidatit shënohet cilës parti i përket kandidati”, e për rrjedhojë edhe miratimi i këtyre listave nga KSHZ dhe KZAZ-të respektive është bërë në kundërshtim me ligjin. Po sipas përfaqësuesit të subjektit ankues, kjo paligjshmëri e zgjedhjeve pararendëse ka sjellë si pasojë pamundësinë e përlllogaritjes së numrit të votave për këshillat vendorë për partitë politike pjesë përbërëse të subjektit zgjedhor koalicioni “Bashkë Fitojmë”, paligjshmëri që sipas tij mund të zgjidhet me kërkesën ankimore objekt i këtij shqyrtimi administrativ nga KAS.

8. Tashmë praktika zgjedhore si ajo administrative (KAS), por po ashtu edhe ajo gjyqësore (Kolegji Zgjedhor Gjyqësor) kanë krijuar standard sa i përket koalicioneve dhe të drejtave/detyrimeve që partitë politike pjesëmarrëse në to mbartin. Më konkretisht, me vendimin Nr. 8 Regj. Them., datë 19.04.2021, Kolegji Zgjedhor, ndër të tjera, ka arsyetuar se:

“... duhen dalluar dy situata qartësisht të ndryshme me njëra-tjetrën të cilat kanë si parakusht formën e garimit në zgjedhje të një partie politike siç është dhe PDIU. Nëse kjo parti politike

do të paraqitej e vetme në zgjedhje, duke paraqitur listën e vetë të kandidatëve, atëherë ajo do të gëzonte të plota të drejtat që i njeh Kodi Zgjedhor, përfshirë dhe ato sipas neneve 95, 96 e 183(8) të këtij Kodi. PDIU në këtë rast do të paraqitej si subjekt zgjedhor më vete, në kuptim të nenit 63(1) të Kodit Zgjedhor. Kjo dispozitë referuar personave juridikë që veprojnë si parti politike njeh si subjekte zgjedhore vetëm dy kategori: 1) partinë politike që garon e vetme dhe paraqet po e vetme listë kandidatësh për konkurrim në zgjedhje dhe 2) koalicionin e disa partive politike, i cili paraqet listë kandidatësh për garim në zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë. Varësisht formës së futjes në garë të një partie politike (e vetme apo në koalicion), rrjedhin edhe disa kufizime të të drejtave të veta sipas Kodit Zgjedhor, të cilat lidhen e me cilësinë si subjekt zgjedhor të partisë politike.

21. Në rastin konkret, neni 65(3) i Kodit Zgjedhor ka përcaktuar shprehimisht se “Për nevojat e zbatimit të këtij ligji, të gjitha të drejtat dhe detyrimet që ky ligj përcakton për subjektet zgjedhore përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit”. Përshtet nga ky rregull bëhet vetëm nëse ligji e parashikon shprehimisht një gjë të tillë, sipas natyrës së të drejtës që diskutohet. Ky formulim është shtuar me ligjin nr. 118/2020, datë 5.10.2020 dhe për rrjedhojë si rregullim i miratuar më vonë në kohë, kushtëzon dhe përcakton kuptimin e dispozitave të tjera të Kodit Zgjedhor, të cilat krijojnë përplasje me të. **Duke qenë se në rastin konkret, subjekt zgjedhor garues është koalicioni PD-AN, këtij i përkasin të gjitha të drejtat dhe detyrimet që Kodi parashikon për subjektet zgjedhore, në lidhje me administrimin e zgjedhjeve të 25 prillit 2021. Ky koalicion përfaqësohet nga Partia Demokratike dhe me të drejtë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vlerësuar se meqë PD ishte tashme e përfshirë në përcaktimin e kryetarit apo nënkryetarit të KZAZ-ve, në zbatim të nenit 96 të Kodit Zgjedhor, e drejta e propozimit të anëtarit të katërt, duhet t’i kalonte LSI-së. LSI duke mos qenë në koalicion me Partinë Demokratike, në dallim nga PDIU, ka ruajtur për vete të gjitha të drejtat që i njeh Kodi Zgjedhor, në lidhje me fazën e kontributit të subjekteve zgjedhore në administrimin e zgjedhjeve. PDIU në këtë rast, përse i përket të drejtës për propozim të anëtarit të katërt, apo për efekt të përfshirjes në short bashkë me LSI, duke qenë se është përfshirë në koalicionin PD-AN, vlerësohet se barazohet me pozitën e PD (kjo e fundit përmbush të gjitha të drejtat që rrjedhin nga Kodi Zgjedhor për subjektin garues në zgjedhje) e cila tashmë e ka të drejtën për propozimin e një anëtari të GNV. Kjo do të thotë se e drejta spostohet te LSI dhe vetëm nëse kjo e fundit (si subjekt i vetëm që mbetet e që**

plotëson kriteret ligjore sipas nenit 96(1) të Kodit Zgjedhor) zgjedh të mos propozojë anëtarin e katërt të GNV, atëherë në zbatim të nenit 96 (1/1) të Kodit Zgjedhor, e drejta i rikthehet PD, e cila vepron si përfaqësuese e koalicionit PD-AN. Në këtë rast hipotetik, PD-ja mund të zgjidhte në marrëveshje me PDIU, që të caktonte konkretisht përfaqësues të kësaj të fundit në të gjitha apo një pjesë të GNV-ve.

22. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vëren se neni 96 i Kodit Zgjedhor ka mbetur i pandryshuar që nga vitit 2012 dhe rregullat e përcaktuara në të, duhet të shihen në dritën e ndryshimeve substianciale që solli ligji nr. 118/2020, datë 5.10.2020, veçanërisht në lidhje me kuptimin e të drejtave të subjekteve garuese në zgjedhje, sipas nenit 65(3) të Kodit Zgjedhor. PDIU nuk mund të veprojë sikur nuk është pjesë e PD-AN, pasi ajo me vullnetin e saj të lirë është bërë pjesë e një koalicioni garues në zgjedhjet e 25 prillit 2021. Duke u futur në këtë koalicion PDIU ka pranuar të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin jo vetëm nga marrëveshja e nënshkruar nga të gjitha partitë, por dhe nga efektet që rrjedhin nga zbatimi i arsyeshem i dispozitave të caktuara të Kodit Zgjedhor. ... për efekt të zbatimit të nenit 96 të Kodit Zgjedhor (në vështrim të nenit 65(3) të këtij kodi), **pozita e PDIU shkrihet me atë të PD, e cila është partia udhëheqëse e koalicionit PD-AN, i cili gëzon cilësinë e subjektit garues në zgjedhjet e 25 prillit 2021**".

9. Për t'u rikthyer te çështja objekt shqyrtimi, në interpretim *a contrario* të përfundimeve të arritura nga Kolegji Zgjedhor në çështjen e mësipërme, duke qenë se Partia e Lirisë ka garuar si pjesë e një koalicioni (Bashkë Fitojmë) në zgjedhjet e 14 majit 2023, së bashku me Partinë Demokristiane dhe Partinë e Bashkimit për të Drejtat e Njeriut, por që **parti udhëheqëse e koalicionit, në kuptim të nenit 65 pika 3 të K.Zgjedhor, ka qenë Partia e Lirisë, atëherë kjo e fundit barazohet me koalicionin në raport me palët e treta, subjektet e tjera zgjedhore ku përfshihet dhe ankimuesi Partia Demokratike e Shqipërisë.**

10. Neni 65 pika 3 i K.Zgjedhor parashikon se "Në momentin e regjistrimit, koalicioni duhet të deklarojë *partinë politike udhëheqëse të koalicionit. Për nevojat e zbatimit të këtij ligji, të gjitha të drejtat dhe detyrimet që ky ligj përcakton për subjektet zgjedhore përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit. Marrëdhëniet midis partive pjesëtare të koalicionit dhe detyrimet reciproke midis tyre rregullohen në marrëveshjen e koalicionit, e cila është pjesë e dokumentacionit që depozitohet nga*

koalicioni në KQZ". Duke qenë se partitë politike pjesëtare në koalicionin "Bashkë Fitojmë" nuk kanë përcaktuar në marrëveshjen e lidhur midis tyre ndonjë rregullim në lidhje me të drejtat që ato përfitojnë apo detyrimet që mbartin gjatë procesit të administrimit zgjedhor, atëherë është e qartë që të gjitha këto të drejta dhe detyrime do të përmbushen nga Partia e Lirisë si parti udhëheqëse e koalicionit.

11. Në lidhje me argumentin e ankimesit se subjekti zgjedhor koalicioni "Bashkë Fitojmë" e ka humbur personalitetin juridik me përfundimin e periudhës zgjedhore për zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023, ndaj nuk mund të përfitojë të drejta për zgjedhje të tjera, theksojmë se së pari është K.Zgjedhor që në nenin 29 pika 4 e tij garanton vazhdimësinë e përfitimit të të drejtave për partinë udhëheqëse të koalicionit për aq kohë sa parashikon se *"Në rastin e zgjedhjeve vendore, renditja përcaktohet mbi bazën e numrit të votave të fituara në shkallë vendi për këshillat vendore në zgjedhjet pararendëse nga partitë parlamentare"* dhe së dyti përfitimi i këtyre të drejtave nga partia udhëheqëse e një subjekti zgjedhor koalicion, nuk nënkupton vazhdimësinë e personalitetit juridik të koalicionit, por vazhdimësinë e përmbushjes së të drejtave dhe detyrimeve nga partitë politike siç e parashikon K.Zgjedhor.

12. Si fillim pala ankimuese e bazoi pretendimin e saj në faktin që duke qenë se koalicioni "Bashkë Fitojmë" në listat shumëmemërore për këshillat vendore nuk kishte shënuar përbri emrit të kandidatit cilës parti i përket ai, atëherë numri i votave për secilën parti pjesëtare në koalicion duhet të përlllogaritet me mesataren e votave, pra duke pjesëtuar numrin e përgjithshëm të votave që koalicioni ka marrë në rang vendi (247.883 vota) me tre (numri i partive politike pjesëtare në koalicion), nga e cila përfitohet vlera 82.627, që sipas palës ankimuese duhet të jetë dhe numri i votave për secilën parti politike pjesëtare në koalicion. Duke qenë se kjo shifër është më e vogël se numri i votave në rang vendi të Partisë Demokratike të Shqipërisë (103.723 vota), atëherë duhet të konsiderohet kjo e fundit si parti e parë e opozitës parlamentare. Për KAS ky argument nuk qëndron pasi K.Zgjedhor nuk ka parashikuar asnjë formulë të tillë për përlllogaritjen e votave për partitë pjesëtare në koalicion në rastin kur për koalicionet përbri emrit të kandidatit nuk shënohet cilës parti i përket kandidati. Në këto kushte, referuar vendimit nr. 186, datë 03.06.2020 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë që ndër të tjera arsyeton se:

“Pavarësisht qëndrimeve të vërejtura në jurisprudencën kushtetuese për pozicionin e një “ligjvënësi pozitiv”, Gjykata Kushtetuese nuk ka pasur për qëllim zhvendosjen ose zëvendësimin e parlamentit nga ushtrimi i pushtetit të tij si ligjbërës (shih vendimet nr.18/2003; nr.1/2005; nr. 19/2007; nr.12/2010 të Gjykatës Kushtetuese).

45. Në linjën e këtij qëndrimi konstant të jurisprudencës kushtetuese, Kolegji vlerëson të nevojshme të theksojë se ometimi mund të shmanget jo vetëm nga institucionet ligjbërëse dhe Gjykata Kushtetuese, por edhe nga gjykatat e zakonshme, nëpërmjet interpretimit të ligjeve, zbatimit të ligjit me analogji, respektimit të parimeve të përgjithshme, etj. Konstatimi i ometimit nga gjykatat e zakonshme, sidomos në aktet nënligjore, kufizohet vetëm për marrëdhënien juridike konkrete të lidhur me çështjen që shqyrtohet prej saj. Kështu, zgjidhja e çështjeve konkrete nga gjykatat e sistemit të zakonshëm, duke pasur për orientim zbatimin e drejtpërdrejtë të dispozitave të Kushtetutës (neni 4), të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara (neni 122), të jurisprudencës së GjEDNJ (neni 17) dhe, në veçanti, interpretimet përfundimtare të kryera nga Gjykata Kushtetuese (neni 132, 145), mund të realizohet, kur është rasti, edhe nëpërmjet konstatimit të ometimit dhe shmangies së tij, kur vërtetohet se një gjë e tillë është bërë shkak për cenimin e të drejtave të ligjshme.

46. Gjyqtari nuk mund të shmanget nga roli krijues gjatë interpretimit të ligjit, pasi, në rrethana të caktuara, e drejta mund të ekzistojë tej normave pozitive që nxjerr shteti, e drejtë që e ka burimin e saj në rendin juridik kushtetues si një tërësi logjike dhe që funksionon si një korigjuese e normave të shkruara. Gjykatat kanë detyrimin ta gjejnë këtë të drejtë dhe ta bëjnë atë realitet në çështjet që kanë për shqyrtim. Kushtetuta nuk e kufizon gjyqtarin në zbatimin strikt të vullnetit legjislativ në çështjen që i është paraqitur. Funksioni gjyqësor presupozon se nuk ekziston asnjë boshllëk në rendin juridik pozitiv, një kusht që mund të jetë i dëshirueshëm në interes të sigurisë juridike, por që në praktikë është i paarritshëm. Detyra e gjyqtarit nuk kufizohet në interpretimin dhe zbatimin e vendimeve legislative. Ai mund të jetë i detyruar të marrë një vendim në pajtim me vlerat kushtetuese, pra të ndriçojë dhe të zbatojë në vendimet e tij ato koncepte të vlerave që janë pjesë e pandarë e rendit juridik kushtetues, por që në tekstet e ligjeve të shkruara nuk janë shprehur qartë apo në mënyrë të plotë. Në kryerjen e kësaj detyre, gjyqtari duhet të ruhet nga arbitrariteti. Vendimi i tij duhet të bazohet në një arsyetim racional. Ai duhet

të bëjë të qartë që ligji i shkruar nuk arrin ta përmbushë qëllimin e vet për të ofruar një zgjidhje të drejtë për problemin ligjor në shqyrtim. Është pikërisht vendimi i gjyqtarit ai që e mbush këtë hapësirë boshe, duke përdorur arsyen e shëndoshë dhe konceptet e përgjithshme të komunitetit mbi drejtësinë (shih më gjerë vendimin e Gjykatës Kushtetuese Federale gjermane (BVerfGE 34, 269))”

KAS nuk mund të zëvendësojë rolin e Parlamentit dhe të krijojë norma juridike si ato që pretendon pala ankimuese. Nga interpretimi teleologjik dhe historik që i bëhet dispozitave të K.Zgjedhor që kanë lidhje me të drejtën e partive politike për të pasur përfaqësuesit e tyre në procesin e administrimit zgjedhor, duke përfshirë këtu dhe dispozitat për subjektet zgjedhore që organizohen në formën e koalicioneve (dispozita këto të ndryshuara më vonë në kohë – viti 2020), bëhet e qartë që për rastin e koalicioneve, kur pjesëtarët në koalicion nuk kanë përcaktuar terma të tjerë në marrëveshjen e koalicionit, është partia udhëheqëse e koalicionit ajo që përmbush të drejtat dhe detyrimet në procesin zgjedhor.

13. Në lidhje me argumentin alternativ që parashtroi përfaqësuesi i palës ankimuese, atë të mënyrës së grupimit të këshilltarëve të zgjedhur nga listat shumemërore të koalicionit “Bashkë Fitojmë” në këshillat bashkiakë përkatës, është një argument që nuk qëndron në kuptim të K.Zgjedhor, pasi në rastin e zgjedhjeve vendore, së pari K.Zgjedhor renditjen e partive politike nuk e lidh me numrin e mandateve të fituara në këshillat bashkiakë, por me numrin e votave të fituara në rang kombëtar për këshillat bashkiakë dhe së dyti grupet e këshilltarëve, jo domosdoshmërisht përfaqësojnë mandatet e fituara nga një subjekt zgjedhor pasi grupimi në këshillat bashkiakë kryhet në përputhje me orientimin e secilit këshilltar në momente të ndryshme. Përbërja e grupeve të këshilltarëve është e ndryshme nga listat shumemërore të një subjekti zgjedhor për aq kohë sa këshilltarët mund të anëtarësohen apo largohen nga grupet e këshilltarëve, ndërkohë që listat shumemërore janë të pandryshueshme për çdo subjekt zgjedhor nga momenti i depozitimit të tyre në KQZ gjatë periudhës zgjedhore. Këtu vlen t’i referohemi Rregullores për Organizmin dhe Funkcionimin e Këshillit Bashkiak Tiranë. Në nenin 31 pika 1 të kësaj rregulloreje parashikohet se *“Këshilltarët mund të grupohen në përputhje me orientimin e tyre politik. Këshilltari mund të marrë pjesë vetëm në një grupim politik”* ndërkohë që neni 32 pika 1 e po kësaj rregulloreje parashikon se *“Kushtet për anëtarësimin në grup, për largimin nga grupi, të drejtat dhe detyrat e tyre brenda grupit, përcaktohen nga vetë grupi i këshilltarëve”* çka tregon qartë se pavarësisht subjektit zgjedhor

nëpërmjet të cilit janë zgjedhur këshilltarët bashkiakë, në momente të ndryshme mund t'i përkasin grupeve të ndryshme të këshilltarëve që nuk përputhen domosdoshmërisht me emërtimin e subjektit zgjedhor nëpërmjet të cilit janë zgjedhur. Për më tepër shifra prej 113 mandate që u pohua ne seancën e shqyrtimit administrativ nga përfaqësuesi i administratës së KQZ, nuk është një shifër e saktë për atë kohë sa reflekton deklaratimet vetëm në 53 bashki të vendit. Për rrjedhojë numri prej 113 mandatesh i deklaruar individualisht nga këshilltarët bashkiakë të zgjedhur nga listat shumëpartisore të koalicionit “Bashkë Fitojmë”, përveçse nuk përputhet me parashikimet e K.Zgjedhor sa i përket mënyrës së renditjes së partive politike për efekt rezultati në zgjedhjet vendore (për të drejtat që ato përfitojnë në procesin e administrimit zgjedhor), por dhe numerikisht është i pasaktë.

14. Referuar sa më sipër, asnjë prej argumenteve alternative të parashtruara nga pala ankimuese nuk qëndron në raport me renditjen e partive politike për zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023. Ndryshimet kushtetuese dhe ato në K.Zgjedhor të vitit 2020 ndryshuan thelbësisht mënyrën e konkurrimit për partitë politike pjesëtare në një koalicion zgjedhor. Përpara vitit 2020, pavarësisht pjesëmarrjes në një koalicion zgjedhor, secila parti politike konkurronte me listat e saj shumëpartisore, ndërkohë pas këtyre ndryshimeve lista shumëpartisore është e përbashkët dhe një e vetme, njësoj si për partitë politike që konkurrojnë pa qenë pjesë e një koalicioni zgjedhor. Për këtë arsye, për partitë politike që konkurrojnë si pjesë e koalicioneve zgjedhore në zgjedhjet vendore (ku nuk zbatohet votimi parapëlqyës për kandidatët e listave shumëpartisore për këshillat bashkiakë), i vetmi interpretim që mund të bëhet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tyre në procesin e administrimit zgjedhor, është ai që këto të drejta dhe detyrime përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit. Disavantazhi që këto parti politike kanë për shkak të konkurrimit me një listë të vetme shumëpartisore përkthehet në avantazh sa i përket numrit të votave që ato fitojnë duke ju përlllogaritur si e drejtë partisë udhëheqëse të koalicionit.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21, pikën 1, shkronja “b” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, me shumicë votash

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 93, datë 20.08.2023 të depozituar nga “Partia Demokratike e Shqipërisë”.
2. Lënien në fuqi të vendimit nr. 722, datë 19.08.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarët dhe sekretarin e komisionit të zonës së administrimit zgjedhor nr. 11, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Bazuar në pikën 1, të nenit 145, të Kodit Zgjedhor mund të bëhet ankim kundër këtij vendimi në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij, sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit 152 të Kodit Zgjedhor.

Elvin	LAKO	-	Relator	
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar	
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar	(Kundër)
Koli	BELE	-	Anëtar	
Ledio	BRAHO	-	Anëtar	

Mendim pakice

Me vendimin nr. 722, datë 19.08.2023, Komisioneri ka përcaktuar se partia e parë e opozitës parlamentare është Partia e Lirisë, mbështetur në arsyetimin se “në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023, subjekti zgjedhor, koalicioni “Bashkë Fitojmë”, bazuar në dokumentacionin e kandidimit ka deklaruar “Partinë e Lirisë”, si parti udhëheqëse të koalicionit”. Sipas Komisionerit, neni 65 i Kodit Zgjedhor, i kalon partisë udhëheqëse të koalicionit të gjitha të drejtat dhe detyrimet që ky ligj përcakton për subjektet zgjedhore. Për pasojë edhe votat e fituara nga koalicioni në zgjedhjet e datës 14 maj 2023 duhet t’i njihen partisë udhëheqëse të tij.

Kjo referencë ligjore dhe i gjithë arsyetimi ligjor që rrjedh prej saj, në vlerësimin tim janë të gabuara dhe nuk gjejnë mbështetje në ligj.

Pika 3 e nenit 65 e ka fushën e veprimit të kufizuar. Kjo dispozitë zbatohet vetëm në zgjedhje dhe vetëm për atë që vazhdojnë ato, sepse dispozita ka për objekt sjelljen e koalicionit si subjekt zgjedhor dhe partinë udhëheqëse të tij si përgjegjëse ligjërish për sjelljen e koalicionit si subjekt zgjedhor.

Me mbarimin e zgjedhjeve, koalicioni pushon së ekzistuari, për pasojë pushojnë së ekzistuari të drejtat dhe detyrimet e partisë udhëheqëse në raport me koalicionin dhe KQZ-në. Partia udhëheqëse nuk mbahet më përgjegjëse nga KQZ-ja p.sh., për plotësimin e detyrimeve të partive pjesëtare të koalicionit për raportimin e shpenzimeve të fushatës, nuk i nënshtrohet auditimit për llogari të partive pjesëtare të koalicionit, nuk detyrohet të kthejë fonde mbrapsht për llogari të tyre, sikurse nuk paguan gjobat dhe penaltetet që KQZ-ja u ngarkon partive pjesëtare të koalicionit.

Dispozita e pikës 3 të nenit 65 të Kodit Zgjedhor është dispozitë që synon të lehtësojë dhe dispijnojë komunikimin dhe kërkesën e llogarisë nga KQZ-ja tek partitë pjesëtare të koalicionit, si dhe të qartësojë marrëdhëniet që partitë pjesëtare të koalicionit duhet të vendosin me njera-tjetrën në funksion të procesit zgjedhor. Asgjë më shumë se kaq. Në thelb dispozita përcakton, se një porosi e dhënë nga KQZ-ja partisë udhëheqëse të koalicionit, për efekt të kësaj dispozite, konsiderohet se u është dhënë të gjitha partive pjesëtare të tij, sikundër një kërkesë e paraqitur nga partia udhëheqëse e koalicionit konsiderohet se ka mbështetjen e të gjitha partive pjesëtare të tij.

Kjo dispozitë “për komunikimin dhe kërkesën e llogarisë” është interpretuar në mënyrë të përsëritur nga Komisioneri në kundërshtim me natyrën dhe qëllimin e saj, duke i dhënë pozicion të privilegjuar, jashtë ligjit, partive të caktuara udhëheqëse të koalicioneve të caktuara.

Vendimi i Komisionerit nr. 722, datë 19.08.2023 ka pasur në objekt identifikimin e partive politike që do të propozojnë anëtarët dhe sekretarin e komisionit të zonës së administrimit zgjedhor nr. 11, për zgjedhjet e pjesëshme për kryetar të bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023. Identifikimi i tyre bëhet në bazë të peshës elektorale që **partitë parlamentare** kanë arritur në zgjedhjet pararendëse vendore, “mbi bazën e numrit të votave të fituara në shkallë vendi për këshillat vendorë” (pika 4 e nenit 29 të Kodit Zgjedhor).

Përpara ndryshimeve që iu bënë Kodit Zgjedhor me ligjin nr. 118/2020 pesha elektorale e partive pjesëtare të koalicioneve përcaktohej nga votat që merrnin këto parti, sepse formimi i koalicioneve me listë të përbërë e lejonte këtë mundësi. Pas heqjes së mundësisë ligjore për të formuar koalicione me listë të përbërë dhe pamundësisë për të identifikuar drejtpërdrejt, nëpërmjet votës, peshën specifike të secilës parti pjesëtare të koalicionit, Kodi Zgjedhor adoptoi një mekanizëm të tërthortë kalkulimi, atë të kalkulimit nisur nga numri i mandateve të fituara nga partia pjesëtare e koalicionit (shih nenet 7 dhe 9 të ligjit nr. 118/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”).

Amendamentet e fundit të Kodit Zgjedhor kanë përcaktuar, se kur paraqiten listat e kandidatëve të koalicioneve duhet doemos që “përbri emrit të kandidatit (të) shënohet cilës parti i përket kandidati” (pika 4 e nenit 67 të Kodit Zgjedhor).

Kodi e ka detajuar më tej edhe formulën e kalkulimit të votave të vlefshme që i takojnë partive pjesëtare të koalicioneve. “Për partitë pjesëtare në koalicion, numri i votave të vlefshme takuese për llogaritet duke mbledhur mesataren e votave për mandat për çdo kandidat të zgjedhur nga radhët e tyre” saktësohet në pikën 3 të nenit 88 të tij.

Kodi e ka vendosur rregullin për kalkulimin e peshës elektorale të partive pjesëtare të koalicioneve në nenin 88 të tij. Ky nen ka për objekt rishpërndarjen e fondeve publike për zgjedhjet në bazë të votave të vlefshme të fituara në to. Por Kodi nuk mund të vendosë dy mekanizma konkurrues matjeje

për realizimin e të njejtit qëllim, kalkulimin e peshës elektorale të një partie pjesëtare në koalicion (edhe t'i llogarisë apriori partisë udhëheqëse të koalicionit edhe votat e aleatëve të tjerë edhe të zbatojë formulë matematikore për identifikimin e peshës specifike të secilës parti pjesëtare në koalicion). Peshat elektorale të një partie politike në një raund zgjedhjesh është unike. Nuk mund të ketë dy rezultate të ndryshme që të tregojnë peshën elektorale të partisë për të njejtat zgjedhje.

Në vlerësimin tim, KAS-i nuk duhet të kishte asnjë dilemë lidhur me faktin se peshat elektorale të partisë politike "Partia e Lirisë" duhet të kalkulohet sipas formulës së përcaktuar nga pika 3 e nenit 88 të Kodit Zgjedhor. Numri prej 247 883 votash të vlefshme duhet të pjesëtohet me numrin prej 292 mandatesh të fituara nga koalicioni "Bashkë Fitojmë", për të nxjerrë mesataren e votave për mandat dhe shifra që del nga ky pjesëtim duhet të shumëzohet me numrin e mandateve të këshilltarëve që ka fituar Partia e Lirisë.

KAS-it i takonte të analizonte dhe vlerësonte ligjërisht dy fakte të rëndësishme juridike, që kanë ndodhur në zgjedhjet e datës 14 maj 2023:

1. Në zgjedhjet e datës 14 maj 2023 koalicioni "Bashkë Fitojmë" ka anashkaluar detyrimin e përcaktuar nga pika 4 e nenit 67 të Kodit për deklarimin e përkatësisë partiake të secilit kandidat të listës shumëmemërore dhe administrata zgjedhore ka pranuar regjistrimin e listave të kandidatëve për këshillat bashkiakë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit dhe të nenit 7 të udhëzimit të Komisionerit nr. 1, datë 18.01.2023. Për pasojë është e pamundur që të përcaktohet numri i mandateve të fituara nga subjekti "Partia e Lirisë", nisur nga dokumentat e kandidimit.
2. Në zgjedhjet e datës 14 maj 2023, grupimi politik i ashtuquajtur i "Rithemelimit" dhe që drejtohet nga z. Sali Berisha, të cilit me vendimin e Komisionerit nr.158, datë 09.03.2023 iu ndalua pjesëmarrja në këto zgjedhje, mori pjesë de fakto në zgjedhje, si pjesëtar i "fshehtë" i koalicionit "Bashkë Fitojmë" dhe një pjesë e konsiderueshme e kandidatëve fitues nga listat e koalicionit i takojnë këtij grupimi politik.

Në vlerësimin tim, fakti i parë juridik, mungesa e të dhënave për përkatësinë e kandidatëve në dokumentat e kandidimit, nuk mund të pranohet si "autorizim" për moszbatimin e formulës së pikës 3 të nenit 88 të Kodit Zgjedhor. Ka qenë detyrë e Komisionerit që të siguronte në rrugë

administrative, a posteriori, informacionin e munguar nga dokumentacioni zgjedhor, si duke kërkuar informacionin e saktë nga subjekti “Partia e Lirisë”, ashtu dhe duke e plotësuar/konfrontuar atë me të dhënat që rezultojnë nga deklaratat e përkatësisë që kanë bërë këshilltarët bashkiakë në procedurën e kushtituimit të këshillave.

Informacioni i grumbulluar mbi të dhënat faktike në momentin e kushtituimit, në çdo rrethanë dhe në çdo rast hipotetik është identik ose pothuaj identik me informacionin që do rezultonte nga dokumentacioni zgjedhor. Për këtë arsye, përdorimi i të dhënave të përfuara nga ky informacion, në kushtet e mungesës së të dhënave nga dokumentacioni zgjedhor është plotësisht i justifikueshëm ligjërisht. I pajustificueshëm ligjërisht është përdorimi i të dhënave që dihet se janë arbitrare dhe që devijojnë shumë nga realiteti i gjërave, sikurse është atribuimi i rezultatit të koalicionit partisë udhëheqëse të tij, kur dihet që peshën kryesore në atë koalicion e ka pasur pjesëtari i “fshehtë” i tij, grupimi i ashtuquajtur i “Rithemelimit”, i drejtuar nga z. Sali Berisha.

Fakti i dytë juridik paraqet rëndësi në rastin konkret, sepse duhet vlerësuar drejt dhe duhet ndarë qartë grupimi politik i ashtuquajtur i “Rithemelimit” nga partia politike “Partia e Lirisë”. Grupimi i ashtuquajtur i “Rithemelimit” ka siguruar, brenda koalicionit, numrin më të madh të këshilltarëve në shkallë vendi. Për shkak të pjesëmarrjes së “fshehtë” në zgjedhje dhe të konfliktit ende në vazhdim për emrin e partisë, këshilltarët e këtij grupimi janë deklaruar në këshillat vendorë si përfaqësues të “Bashkë Fitojmë”, të koalicionit, i cili u formua për qëllime elektorale dhe që nuk ka identitet juridik. Këshilltarët që i përkasin subjektit “Partia e Lirisë” janë deklaruar në këshillat vendore si këshilltarë të kësaj të fundit.

Nga investigimi i kryer prej administratës së KQZ-së pranë 61 këshillave bashkiake rezulton, se kudo ku grupimi i ashtuquajtur i “Rithemelimit” dhe Partia e Lirisë kanë këshilltarë, këta janë deklaruar përkatësisht këshilltarë të “Bashkë Fitojmë” dhe të Partisë së Lirisë. Në asnjë rast të vetëm nuk rezulton që këshilltarët e secilit prej këtyre dy formacioneve politike të jenë identifikuar me një emër tjetër formacioni politik.

Nga investigimi administratës rezulton se Partia e Lirisë ka 113 këshilltarë bashkiakë në 46 këshilla bashkiake nga 61 që janë gjithësej. Përfaqësuesi ligjor i Partisë së Lirisë mungoi në këtë seancë shqyrtimi. Për këtë arsye, kjo shifër nuk mund të konfrontohet me të dhënat që disponon vetë

subjekti, por ajo është e përafërt me shifrën prej 111 këshilltarësh që pala e interesuar pretendon se janë deklaruar si të Partisë së Lirisë.

Mbështetur në këtë analizë të fakteve çmoj se mund të bëhet kalkulimi ligjërisht korrekt i peshës elektorale të Partisë së Lirisë, duke shumëzuar shifrën 849 (numri mesatar i votave të vlefshme për mandat) me numrin prej 113 mandateve të fituara në shkallë vendi. Rezultati prej 95 937 votash përfaqëson peshën reale elektorale të subjektit “Partia e Lirisë”. Kjo shifër është më e ulët se shifra prej 103 723 votash që ka fituar subjekti “Partia Demokratike” në zgjedhjet e datës 14 maj 2023.

Në këtë çështje nuk ka vend për të analizuar të dhënat që i përkasin grupimit të ashtuquajtur të “Rithemelimit”, që drejtohet nga z. Sali Berisha, për të nxjerrë peshën elektorale të tij dhe për të diskutuar nëse i takon e drejta për të propozuar anëtarët e KZAZ-së, pasi ky formacion politik nuk mund të përfshihet në lëndën e vendimit nr. 722, datë 19.08.2023, për shkak se i mungon statusi i partisë parlamentare, që është kusht për t’u marrë në konsideratë.

Mbështetur në këto fakte dhe në këtë analizë ligjore gjykoj se vendimi i Komisionerit nr. 722, datë 19.08.2023 duhet të ishte ndryshuar nga KAS-i në shkronjën “b” dhe “c” të pikës 1 të tij, si më poshtë:

- b) dy anëtarë propozohen nga “Partia Demokratike” (PDSH);
- c) një anëtar propozohet nga “Partia e Lirisë” (PL).

Për rrjedhojë duhet të ishte shfuqizuar pika 2 dhe ndryshuar pika 3 si më poshtë:

- 3. Sekretari i KZAZ-së nr. 11 do të propozohet nga “Partia Demokratike”.

Anetar – Ilirjan RUSMALI